



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA




RAPORTI MBI SHPENZIMET E KOMUNËS GJILAN

PARATË DHE POLITIKA



AVANCOJMË KOSOVËN SË BASHKU

LOCAL
SOLUTION



RAPORTI MBI SHPENZIMET E KOMUNËS

GJILAN

PARATË DHE POLITIKA

● ● AVANCOJMË KOSOVËN SË BASHKU





Implementing Persons and Organizations for this report:

ERJONA HURUGLICA – Kosovo Center for International Cooperation

Financuar nga:



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERICKOG NARODA





Përshkrimi i projektit:

Ky projekt i mbështetur nga Advancing Kosovo Together – Local Solutions (AKT-LS) përmes USAID, ka për qëllim të rrisë integritetin e qeverive lokale duke shtuar monitorimin nga shoqëria civile në këto komuna. Pjesëmarrësit në këtë projekt janë aftësuar: të kenë çasje në informatat për tenderët publikë në nivel komunash, të identifikojnë lidhjet politike në mes të kompanive apo personave që kanë fituar tenderë por që më herët kanë qenë donator të partive politike, gjithashtu edhe verifikimin e deklaramit të pasurisë së zyrtarëve të lartë shtetëror. Pjesëmarrësit kishin për detyrë që këto njohuri t'i aplikojnë në komunat e tyre dhe të shkruajnë një raport mbi të gjaturat. Kjo punë reflekton njohuritë dhe metodologjinë e fituar nga trajnimi.

Deklaratë mohimi

Pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë punë e pjesëmarrësve në këtë projekt. Hulumtimi në këto raporte është vetëm punë e këtyre personave dhe jo e organizatave përfaqësuese. Ato gjithashtu nuk reflektojnë qëndrimet e donatorëve të këtij projekti, United States Agency for International Development (USAID). Këto pikëpamje gjithashtu nuk paraqesin qëndrimet e organizatave implemetuese Communication for Social Development dhe Organizatës Çohu!.

Publikuar nga

Organizata për Demokraci, Antikorrupsion dhe Dinjitet, Çohu!
Rruga: Rustem statovci Nr.17; Prishtinë, Kosova
Tel / +381 (0)38 248 506
www.cohu.org

PËRMBAJ

08

Hyrje

10

Shpenzimet
kapitale

09

Të gjeturat
kryesore

25

Raportet e
Auditimit

TJA

31

Vendimet
e Organit
Shqyrtues të
Prokurimit,
(OSHP)

32

Financimi i
Subjekteve
Politike

34

Lidhja e
bizneseve me
subjektet politike

36

Përfundime dhe
rekomandime



RAPORTI MBI SHPENZIMET E KOMUNËS

GJILAN

HYRJE

Hulumtimi i tillë për Komunën e Gjiilanit, përfshinë periudhën 2010 – 2015. Gjatë periudhës së tillë, Komuna e Gjiilanit është ballafaquar me vështirësi funksionale sa i përket menaxhimit të buxhetit publik dhe shpenzimeve të parapara në buxhet, ndër tjera.

Fillimisht Komuna e Gjiilanit ishte ballafaquar me problemin e planifikimit të shpenzimeve si dhe realizimit të tij.

Ndër problemet tjera të cilat kanë vazhduar ta përcjellin Komunën Gjiilanit përgjatë viteve janë edhe mos-respektimi e dispozitave ligjore të prokurimit publik, problemet me njoftimin për dhënie të kontratës si dhe dhënia e kontratës OE (Operatori Ekonomik), të cilët nuk kishin plotësuar kriterin për veprimtari përkatëse sipas kërkesës së specifikuar, anashkalimi i procedurave të prokurimit publik me rastin e shpalljeve të hapura publike.

Sa u përket zbatimit të dispozitave të prokurimit publik, vështirësi ishin identifikuar edhe me rastin e ekzekutimit të kontratave me ç'rast është vonuar në përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kontrata, dhënie e kontratave operatorëve ekonomik të papërgjegjshëm dhe probleme tjera të identifikuara në periudhën 2010 – 2015.

Ndërsa, në pikën e lidhjes së bizneseve me politiken (subjektet politike), hulumtimi ka identifikuar biznese të shumta të cilat në një apo tjetër formë, kanë pasur lidhje me politiken. Në hulumtim si në vijim, janë përfshirë të gjeturat dhe lidhja e bizneseve me subjektet politike.

TË GJETURAT KRYESORE

Në planifikimet për shpenzimet buxhetore për çdo vit, në periudhën 2010 – 2015 si dhe gjatë procedimeve në procedurat e prokurimit publik, si probleme dhe vështirësi kryesore janë identifikuar të gjeturat si në vijim:

- Mos-planifikim i duhur i shpenzimeve buxhetore;
- Shkelje e dispozitave të prokurimit publik;

- Anashkalim i dispozitave të prokurimit publik me rastin e njoftimeve publike;

- Mos-zotim i mjeteve para inicimit të procedurave të prokurimit publik;

- Vonesa në ekzekutimin e punëve sipas kontratës;

- Dhënia e kontratës operatorit ekonomik të pa përgjegjshëm;



PLANIFIKIMI DHE SHPENZIMI PËRFUNDIMTAR I KOMUNËS SË GJILANIT PËRGJATË VITIT 2010-2015 ËSHTË SI VIJON



2010



2011



2012



2013



2014



2015

2010

Buxheti i planifikuar për vitin 2010 ishte **19,749,986.94 euro**, ndërsa i realizuar përgjatë një viti i mbledhur nga të gjitha kategoritë shpenzuese është **19,239,320.01 euro**. Dallimi i pashfrytëzueshmërisë është **510,666.93** para të pashfrytëzuara nga Komuna.



Në analizimin e buxhetit të Komunës së Gjilanit shohim se planifikimi për Departamentin e Prokurimit është **37,545.00 euro** ku përfshihen Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shër-

bime, Shpenzime Komunale, Subvencione dhe Transfere si dhe Shpenzime Kapitale, ndërsa të realizuara për këtë departament janë **37,003.96 euro** në të gjitha kategoritë e lartcekura.

Buxheti i vitit 2010 i planifikuar për shpenzime kapitale është **7,284,482.70 euro** ndërsa i realizuar është **7,126,450.49 euro** me ç'rast është shfrytëzuar për projekte dhe ngritje kapitale në kategoritë si vijon:

SHPENZIMET KAPITALE (2010)

Departamenti/ **Planifikuara** Realizuara
Programi



PROJEKTET TË INVESTIMEVE NË KOMUNËN E GJILANIT TË REALIZUARA NËPËR DEPARTAMENTE DHE PROGRAME TË NDRYSHME:

Departamenti/ Programi	Totali i shpenzimeve kapitale
Zyra e Kryetarit	6,359,062,23
Administrata e Parteshit*	246,394,00
Zyra Lokale për Komunitete	13,937,60
Bujqësi	16,080,00
Shëndetësi	31,000,00
Arsim	459,976,66
TOTALI	7,126,450,49

* Komuna e Parteshit është themeluar me 19 Gusht, 2010, kur edhe u mbajt mbledhja e parë konstituive e Kuvendit Komunal. Deri atëherë, kjo zonë ishte pjesë e komunës së Gjilanit.

Kontratat e nënshkruara përmes prokurimit publik

Bazuar në hulumtimin tonë dhe rishikimin e dokumenteve që janë të gjetura në web faqen Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) të përgjithshëm nxirren dhe të dhënat për çdo tender të dhënë për vite me radhë që janë target i hulumtimit. Që nga viti 2010 janë nxjerrë që të gjitha njoftimet për dhënie të kontratës duke e përmbushur edhe data bazën me të dhënat e nevojshme dhe me krahasimet target i hulumtimit.

Në vitin 2010 janë regjistruar nga ana jonë dhe janë rishikuar gjithsej 85 tenderë mirëpo në 4 prej tenderëve nuk kanë shumë të përgjithshme të tyre, të llogaritur janë vetëm 81. Shuma e përgjithshme e këtyre 81 tenderëve është 6,798,986.39 euro

Nga 85 tenderët e rishikuar dhe sipas llojit të kontratave si vijon:




Ndërsa shuma e secilit prej tenderëve në baze të lloji të kontratës së tenderit variojnë kështu:

Punë € 5,560,639.31	Furnizime € 1,134,927.08	Shërbime € 103,420.00
-----------------------------------	--	-------------------------------------


Në bazë të data bazës dhe hulumtimit ekzistojnë një numër i madh i kompanive të cilat kanë qenë fituese të tenderëve. Në vazhdim janë dy kategori të kompanive

njëra kategori është me më së shumti shumë të fituar të tenderëve dhe tjera janë kompanitë të cilat kanë fituar më së shumti tenderë në numër.

Top 5 kompanitë me shumën më të madhe të fituar



Kompanitë me numrin më të madh të tenderëve të fituar



2011


Buxheti i planifikuar për vitin 2011 ishte 19,456,971,41 euro ndërsa i realizuar përgjatë një viti i mbledhur nga të gjitha kategoritë shpenzuese është 19,247,705.96. Dallimi i pashfrytëzueshmërisë është 209,265,45 euro para të pashfrytëzuara nga Komuna.

Në analizimin e buxhetit të Komunës së Gjiçanit shohim se planifikimi për Departamentin e Prokurimit është 52,027.00 euro ku përfshihen Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime Komunale, Subvencione dhe Transfere si dhe

Shpenzime Kapitale, ndërsa të realizuara për këtë departament janë 52,019.27 euro në të gjitha kategoritë e lartcekura. Edhe te Departamenti i Prokurimit kemi ndryshime, kësaj here Departamenti i Prokurimit ka rritur shpenzimet që nga viti 2010 që i ka pasur më të ulëta.

Buxheti i vitit 2010 i planifikuar për shpenzime kapitale është 5,499,212,59 ndërsa i realizuar është 5,390,261,99 ku është shfrytëzuar për projekte dhe ngritje kapitale në kategoritë si vijon:

Departamenti/ Planifikuara Shpenzuara Programi



PROJEKTET TË INVESTIMEVE NË KOMUNËN E GJILANIT TË REALIZUARA NËPËR DEPARTAMENTE DHE PROGRAME TË NDRYSHME KANË REZULTUAR TË NDAHEN NË DISA DEPARTAMENTE.

Departamenti/ Programi	Shuma e shpenzimeve kapitale
Zyra e Kryetarit	3,874,547.65
Shërbime Publike	799,696.61
Bujqësi	12,870.00
Administrata	48,864,29
Administrata e Arsimit	654,283,14

Është interesante sepse ky trend i zvogëlimit si tek shpenzimet kapitale si tek ruajtja e parasë në vitin 2011 është shumë i shprehur, mund të marrim rast konkret shpenzimet kapitale të vitit 2010 në krahasim me të vitit 2011.

Zyra e kryetarit si shpenzime kapitale të vitit 2010 ka diku rreth 6 milionë shpenzime kapitale, përderisa në vitin 2011 këto shpenzime janë zvogëluar për diku rreth 3 milionë euro.


Nëse i referohemi data bazës tonë (të dhëna që janë marrë nga KRPP) mund të shohim se shuma e tenderëve të publikuar për vitin 2010 është 6,798,986.39 euro të publikuara në KRPP (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik), ndërsa shuma e përgjithshme e tenderëve në vitin 2011 rezultojnë të jetë 8,585,782.30 euro, rreth 2 milionë euro më shumë sesa viti paraprak.

Kontratat e nënshkruara përmes prokurimit publik

Në vitin 2011 janë shikuar dhe janë regjistruar në data bazën tonë gjithsej 82 tenderë, në numrin e përgjithshëm të këtyre tenderëve 4 prej tyre nuk kanë pasur të shënuar asnjë informatë se çfarë shume të përgjithshme ka ndarë Komuna për atë tenderë;

Shuma e përgjithshme e 78 tenderëve të llogaritur (pa 4 tenderët pa shumë të përgjithshme) është 8,585,702.30 euro;

Nga 82 tenderët e shikuar, llojet e kontratave dhe numri i tenderëve me llojin e kontratës si vijon:




Ndërsa shuma e secilit prej tenderëve në bazë të lloji të kontratës së tenderit variojnë kështu:




Nga 8,585,702 euro të shpenzuara përmes prokurimit publik, pesë kompani kanë fituar 3,995,115 euro apo 46.53% e të gjithë vlerës së tenderëve. Vetëm kompa-

nia Papenburg&Adriani ka fituar përmes tenderëve rreth 1,766,932 euro apo 20.57% të vlerës së përgjithshme.

Kompanitë që fituan më së shumti sipas vlerës së tenderëve



Kompanitë me numrin më të madh të tenderëve të fituar



Buxheti i planifikuar për vitin 2012 ishte 19,108,957.85 euro, ndërsa i realizuar përgjatë një viti, i mbledhur nga të gjitha kategoritë shpenzuese është 18,760,946.26 euro. Dallimi i pashfrytëzueshmërisë është 348,011.59 euro para të pashfrytëzuara nga Komuna.


Në analizimin e buxhetit të Komunës së Gjilanit shohim se planifikimi për Departamentin e Prokurimit është 57,900.00 euro ku përfshihen Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime Komunale, Subvencione dhe Transfere dhe Shpenzime Kapitale, ndërsa të realizuara për këtë departament janë 57,883.07 euro në të gjitha kategoritë e lartcekura.

Buxheti i vitit 2012 i planifikuar për shpenzime kapitale është 4,360,857.89 euro ndërsa i realizuar është 4,402,439.19 euro ku është shfrytëzuar për projekte dhe ngritje kapitale në kategoritë si vijon:

- Është interesante se shpenzimet kapitale nga viti në vit kanë shumë rënie, Në bazë të kësaj dallimi në mes vitit 2010-2012 është rreth 3 milionë euro.
- Përderisa në dokumentet që janë marrë nga Komuna e Gjilanit mund të shihen gjithë variacionet e buxhetit dhe shpenzimet e buxhetit nëpër projekte të caktuara.
- Nëse e shikojmë emrin e projektit të dhënë të çfarëdo viti që i kemi rishikuar në shuma e atyre tenderëve nuk përputhet me shumën që është e publikuar në Njoftimin për dhënie të kontratës në KRPP-(Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik).

SHPENZIMET KAPITALE (2012)

Programi/ Departamenti Planifikuar Shpenzuar




Kontratat e nënshkruara përmes prokurimit publik

Në vitin 2012 në data bazë janë të regjistruar gjithsej 39 tenderë, si rrjedhojë e këtyre tenderëve, 38 tenderë janë tenderë me shumë të mesme dhe një rezultat me shumë të madhe të realizimit të projektit.

Shuma e përgjithshme e këtyre tenderëve është 6,432,013,86;

Nga 39 tenderët e shikuar, tenderët ndahen në llojin e kontratës si vijon:




Ndërsa shuma e secilit prej tenderëve në bazë të lloji të kontratës së tenderit variojnë si në vijim:




Nga 6,432,013 euro të shpenzuara përmes prokurimit publik, pesë kompani kanë fituar 4,576,798 euro apo 71% të vlerës së përgjithshme. Vetëm një kompani përmes tre

tenderëve ka fituar 3,594,850 euro apo 55% të vlerës së përgjithshme.

Kompanitë me shumën më të madhe të fituar në vitin 2012



Kompanitë me numrin më të madh të tenderëve të fituar:



2013


Buxheti i planifikuar për vitin 2013 ishte 21,356,768.23 ndërsa i realizuar përgjatë një viti i mbledhur nga të gjitha kategoritë shpenzuese është 20,622,791.74 euro. Dallimi i pashfrytëzueshmërisë është 733,976.49 euro të pashfrytëzuara nga Komuna.

Në analizimin e buxhetit të Komunës së Gjilanit shohim se planifikimi për Departamentin e Prokurimit është 54,411.00 euro ku përfshihen Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime Komunale, Subvencione dhe Transfere dhe Shpenzime Kapitale, ndërsa të realizuara për këtë departament janë 54,296.75 euro në të gjitha kategoritë e lartcekura.

Buxheti i vitit 2013 i planifikuar për shpenzime kapitale është 5,334,859.03 euro ndërsa i realizuar është 4,826,165.42 euro ku është shfrytëzuar për projekte dhe ngritje kapitale në kategoritë si vijon:

Departamenti/
Programi

Shuma




Kontratat e nënshkruara përmes prokurimit publik

Në vitin 2013 gjithsej në data bazë janë të regjistruar 35 tenderë, në kuadër të këtyre 35 tenderëve vetëm dy nuk kanë shumë përgjithshme të tyre.

Shuma e përgjithshme e këtyre tenderëve është 5,624,492.62 euro. Sipas llojit të kontratës së punës ndahen në kategori si vijon:




Ndërsa shuma e secilit prej tenderëve në baze të lloji të kontratës së tenderit variojnë si me poshtë:



Në vitin 2013 mund të vërehet një fluks më i madh tek kategoria e shërbimeve. Vetëm një tender i llojit të kontratës Shërbime ka qenë pothuajse tenderi më i madh i implementuar në kategorinë e shpenzimeve. Bëhet fjalë për tenderin Pastrimi i rrugëve, trotuareve, rrugicave që komuna e ka implementuar apo e ka dhënë gjatë periudhës së këtij viti.

Nga 5,624,492.62 euro të shpenzuara përmes prokurimit publik, pesë kompani kanë fituar 3,642,574 euro apo 64.76% e vlerës totale

Kompanitë me shumën më të madhe të tenderëve



Kompanitë me numrin më të madh të tenderëve të fituar:



2014

Buxheti i planifikuar për vitin 2014 ishte 22,531,725.19 euro ndërsa i realizuar përgjatë një viti i mbledhur nga të gjitha kategoritë shpenzuese është 21,127,252.96 euro. Dallimi i pashfrytëzueshmërisë është 1,404,472.23 euro të pashfrytëzuara nga Komuna.

Në analizimin e buxhetit të Komunës së Gjilanit shohim se planifikimi për Departamentin e Prokurimit është 60,833.45 euro me ç'rast përfshihen Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime Komunale, Subvencione dhe Transfere si dhe Shpenzime Kapitale, ndërsa të realizuara për këtë departament janë 57,232.16 euro në të gjitha kategoritë e lartcekura.

Buxheti i vitit 2014 i planifikuar për shpenzime kapitale është 4,077,675.81 euro ndërsa i realizuar është 3,831,716.53 euro ku është shfrytëzuar për projekte dhe ngritje kapitale në kategoritë si vijon:

- Vlen të theksohet se shpenzimet kapitale për këtë vit po marrin kahje tek zhvillimet ekonomike, sipas tabelave shihet qartë se për vitin 2014 parim kryesor po i shtohet zhvillimit ekonomik dhe investimeve kapitale në këtë sektor, poashtu edhe zhvillimit të bujqësisë dhe blegtorisë.

Programet/ Departamentet

Shuma

Zyra e Kryetarit		133,405.80 €
Shërbimet Publike		1,028,229.62 €
Bujqësi dhe Pyltari		67,660.00 €
Zhvillim Ekonomik		2,058,283.20 €
Shëndetësi		128,000.00 €
Arsim		416,137.91 €

Kontratat e nënshkruara përmes prokurimit publik

Në vitin 2014 në data bazë janë të regjistruar gjithsej 38 tenderë. Shuma e përgjithshme e këtyre tenderëve është

3,185,425.80 euro para të shpenzuara për realizimin e këtyre tenderëve. Sipas llojit të kontratës vijon si në këtë mënyre

Tenderë	Tenderë	Tenderë
PUNË  21	FURNIZIME  4	SHËRBIME  13

Ndërsa në bazë të lloji të kontratës shuma e këtyre varion si në vijim:




Në vitin 2014 mund të shihet se për llojin e kontratës Punë është investuar diku rreth 2 milionë euro, për furnizime mund të shihet se janë diku rreth 700 mijë euro dhe për shërbime diku rreth 371 mijë euro.

Edhe më lartë shihet se në kategorinë shërbime publike kemi një ngritje fondesh ku komuna e parasheh që përgjatë vitit 2014 të ketë më shumë ngritje të fondeve në shërbime publike për qytetarët.

Çka vlen të potencohet se gjatë analizimit mund të vërejmë se në llojin e kontratës për shërbime kemi ngritje të fondeve për këtë kategori, ku komuna investon më shumë se viteve të fundit sa i përket kategorisë së shërbimeve.

Nga 3,185,425 euro të shpenzuara përmes prokurimit publik, pesë kompani kanë fituar 1,832,247 euro apo 57.5% e vlerës së përgjithshme

Kompanitë me shumën më të madhe të fituar të tenderëve



Kompanitë me numrin më të madh të tenderëve të fituar



2015

Buxheti i planifikuar për vitin 2015 ishte 23,194,382.31 euro ndërsa i realizuar përgjatë një viti i mbledhur nga të gjitha kategoritë shpenzuese është 21,768,303.44 euro. Dallimi i pashfrytëzueshmërisë është 1,426,078.87 euro të pashfrytëzuara nga Komuna.

Në analizimin e Buxhetit të Komunës së Gjilanit shohim se planifikimi për Departamentin e Prokurimit është 65,507.47 euro ku përfshihen Paga dhe Mëditje, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime Komunale, Subvencione dhe Transfere dhe Shpenzime Kapitale, ndërsa të realizuara për këtë departament janë 60,506.25 euro në të gjitha kategoritë e lartcekura.

Buxheti i vitit 2015, i planifikuar për shpenzime kapitale është 3,941,133.57 euro ndërsa i realizuar është 3,270,515.38 euro ku është shfrytëzuar për projekte dhe ngritje kapitale në kategoritë si vijon:

- Shpenzimet kapitale të vitit 2015 si në tabelën e mësipërme, mund të vërehet fakti që e dallon nga shpenzimet kapitale të vitet e tjera është se Zyra e Kryetarit në vitin 2015 nuk ka asnjë shpenzim kapital të bërë pa llogaritur kategoritë e tjera.
- Ndryshe nga vitet e mëhershme në të cilat miliona shpenzoheshin për Zyrën e Kryetarit dhe Projektet e realizuara nga ajo, tani nuk ekziston ndonjë shifër as edhe një qindarkë e shpenzuar për zyrën e Kryetarit.

Programi/ Departamenti

Shuma

Shërbime Publike/ Infrastrukturë dhe banim		866,999.40 €
Bujqësi dhe Pylltari		92,204.50 €
Zhvillim Ekonomik		1,549,526.90 €
Kadastër, Gjeodezi, Pronë		345,758.34 €
Urbanizëm dhe mbrojtje mjedisit		89,399.05 €
Shëndetësi		68,198.09 €
Arsim		258,429.10 €

Kontratat e nënshkruara përmes prokurimit publik

Në vitin 2015 në data bazë janë të regjistruar gjithsej 62 tenderë, në kuadër të këtyre 62 tenderëve vetëm dy tenderë nuk kanë shumë të përgjithshme.

Shuma e përgjithshme e këtyre tenderëve është 6,798,303.72. euro. Këta tenderë variojnë në llojin e kontratës si vijon:


Tenderë	Tenderë	Tenderë
PUNË  31	FURNIZIME  18	SHËRBIME  13

Ndërsa në bazë të lloji të kontratës shuma e këtyre varion si në vijim:



Nga 6,798,303 euro të shpenzuara përmes prokurimit publik, pesë kompani kanë fituar përmes tenderëve publik 4,080,675 euro apo 60% të vlerës së përgjithshme.

Kompanitë me shumën më të madhe të fituar të tenderëve



Kompanitë me numrin më të madh të tenderëve të fituar



RAPORTI AUDITIMIT 2010

Në analizimin e Raportit të Auditimit të vitit 2010 është përpjekur që të gjeturat e auditorit, të fokusohen edhe tek të gjeturat nga hulumtimi ynë. Për më shumë të gjitha gjerat si rekomandimet, Shpenzimet e Prokurimit Publik dhe ato buxhetore të komunës.

Sipas Raportit të auditorit të përgjithshëm janë një mori gjërash që përputhen edhe me databazën tonë si të gjetura jo legale. Fillimisht hulumtimi do të fokusohet te shpenzimet e Prokurimit dhe mënyrën e mbarevajtjes së të dhënave të tenderëve për këtë vit. Sipas Raportit të auditorit në vitin 2010 potencohen disa gjëra.

Auditori ka specifikuar rastin për :

Dhënia e kontratës OE (Operatori Ekonomik) i cili nuk ka plotësuar kriterin për veprimtari përkatëse sipas kërkesës.

Sipas auditorit të përgjithshëm ai potencon në dy pika:

Se përfituesi i tenderit nuk ka lëmin përkatës që ka qenë si kriter përzgjedhës nga Komuna e Gjilanit dhe e dyta, se lloji i thëngjill grurit nuk aludon më specifikacionin e teknikut të kërkuar.

Bazuar në data bazën tonë shohim se kompania fituese e këtij tenderi është "Metali" me shumë të përputhur si në raportin e auditorit 23,250 euro dhe me datë tenderi 14 shtator 2010 dhe me procedurë të hapur të tenderit.

REKOMANDIMI I AUDITORIT PËR KRYETARIN E KOMUNËS:

Respektimin e kontratave dhe përmbushjen e kriterëve të kërkuara sipas dosjes së tenderit;

KOMPENSIMI ME NAFTË I TRANSPORTUESVE PËR TRANSPORTIN E NXËNËSVE.

Sipas auditori të përgjithshëm, Komuna pa shpallje të hapur publike dhe duke e anashkaluar Proceset e Prokurim-

it Publik e ka bërë përzgjedhjen e transportuesve të nxënësve në vijën shtëpi-shkollë të vitit 2009/2010 dhe 2010/2011.

Kompensimi i bërë me derivate të naftës dhe siç është analizuar nga auditori 5 (pesë) ditë pas lidhjes së kontratës, njëri prej transportuesve është furnizuar me naftë prej 2,108 litra në ditë. Ndërsa me kontratë parashihet që të kompensohet 95 litra naftë në ditë.

Bazuar në data bazën tonë mund të shihet se të gjithë tenderët për vitin 2010 që janë dhënë për transport të nxënësve, janë të ndara me lote dhe se janë numër i madh i kompanive të cilat kanë fituar tenderët për transport të nxënësve.

REKOMANDIMI I AUDITORIT PËR KRYETARIN E KOMUNËS:

Analizimin dhe marrjen e masave të duhura administrative për rastet e keqmenaxhimit

PAGESA E ORGANIT MBIKËQYRËS DHE KOMISIONIT PËR PRANIMIN TEKNIK TË PUNËVE.

Komuna çmimit bazë të kontratës i shton edhe shumat për kompensim të organit mbikëqyrës dhe komisionit për pranim teknik. Në vijim tek tenderi për asfaltimin e rrugëve në lagjen Zabeli i Sait Agës, vlera e ofertës ishte 297,116€ të cilit i shtohet kompensimi për organin mbikëqyrës në vlerë prej 4,321€ dhe kompensimi i komisionit për pranim teknik në vlerë prej 3,027€. Pra, vlera e kontratës për pagesë arrin shumën 304,464€. Njëjtë është vepruar edhe për kontrata tjera të ngjashme.

Mirëpo në data bazë figuron vetëm shuma e ofertës pa llogaritur edhe shuma të tjera si kompensimet mbikëqyrëse. Kjo do të thotë se Komuna nuk paraqet në kontratat e publikuara të gjithë shumën e llogaritur por vetëm shumën fillestare, ndërsa akumulon fonde më shumë duke e arsyetuar pagesat për komision mbikëqyrës.

REKOMANDIMI I AUDITORIT PËR KRYETARIN E KOMUNËS:

Kompensimet e organit mbikëqyrës dhe komisionit për pranim teknik të punëve të bëhen jashtë kontratave për punë dhe të mos futen në koston e ndërtimit.

VONESA NË EKZEKUTIMIN E PUNËVE SIPAS KONTRATËS

Te kontrata "Asfaltimi i rrugëve në lagjen Zabeli i Sait Agës", në vlerë prej 304,464€ të datës 17 mars 2010, është paraparë që afati kohor për kryerjen e punëve të jetë 24 ditë pune. Nuk është përfillur plani dinamik. Deri në datën e auditimit, punimet ende nuk kishin përfunduar. Kontratës po ashtu i mungon garancioni bankar për sigurimin e ekzekutimit të punëve siç parashihet me kontratë.

Ndërsa sipas kontratës "Ndërtimi i qendrës memoriale Kodra e Dëshmorëve", faza e I-rë, vlera e së cilës ishte 277,386€, i datës 14 prill 2010, ishte paraparë që afati kohor për kryerjen e punëve të jetë 48 ditë pune. Deri në datën e auditimit, punimet nuk kishin përfunduar. Po ashtu kompania nuk kishte ofruar garancinë bankare për sigurimin e përmbushjes së kontratës.

REKOMANDIMI I AUDITORIT PËR KRYETARIN E KOMUNËS:

- Se projektet janë realizuar me kohë dhe në rastet e vonesave të aplikohen ndëshkimet përkontraktorët që nuk i përmbushin kushtet dhe obligimet e përcaktuara me kontratë;t;
- OE të ofrojnë garancion bankar për sigurinë e ekzekutimit të punëve

RAPORTI I AUDITIMIT 2011

Të gjeturat e auditorit për vitin 2011 në Departamentin për Prokurorimin Publik dhe lëshimet gjatë dhënies të tenderëve janë paraqitur si më poshtë:

VONESA NË FILLIMIN E PUNIMEVE

Në kontratat e nënshkruara si: Kontrata me 29 shtator 2011 "Rregullimi i rrugës - Halim Orana, Fehmi Agani dhe Jugu 1" në vlerë prej 126,486€ dhe tjetra e nënshkruar me 11 tetor 2011 "Ndërtimi i trafostacioneve në fshatin Malishevë e Epërme, Jabuq dhe në lagjen Arbëria 1 dhe 2" në vlerë prej 122,133€, realizimi i projekteve nuk kishte filluar deri në datën e auditimit (punëve në terren).

Në vitin 2010 është vërejtur se pothuajse i njëjti problem është shqyrtuar nga Auditori për Komunën e Gjilanit. Kujtojmë se në vitin 2010 nga Auditori i Përgjithshëm është dhënë një kritikë për kryerjen e punëve me kohë dhe mos daljen jashtë kohës së paraparë. Në vitin 2011 përsëritet përsëritet e njëjta mirëpo në një variant më ndryshe kompanitë fituese nuk kanë filluar me kryerjen e punëve siç është paraparë me kontratë.

MOS ZOTIMI I MJETEVE PARA INICIMIT TË PROCEDURAVE TË PROKURIMIT

Te mostrat e përzgjedhura për tri projektet e përfunduara: "Projekte të vogla-punë publike dhe infrastrukturë" në vlerë prej 115,523€, "Rregullimi i shtratit të lumit Baja" në vlerë prej 216,740€ dhe "Mirëmbajtja teknike e objekteve komunale të KK " në vlerë prej 367,394€, janë paguar 411,172€ dhe në mungesë të mjeteve kanë mbetur të pa paguara edhe 288,485€. Ndërsa për kontratën e nënshkruar "Rregullimi i rrugës - Halim Orana, Fehmi Agani dhe Jugu 1" në vlerë prej 126,486€ dhe 8 (tetë) projektet tjera që janë në proces të përfundimit, obligimet për këto projekte janë 1,120,942€, kurse janë paguar 534,958€. Shuma e gjithëmbarshme e borxheve të pa paguara nga mostra e ekzaminuar ishte 1,123,087€.

REKOMANDIMI I AUDITORIT PËR KRYETARIN E KOMUNËS:

Të mos iniciohen procedurat e prokurimit para se të sigurohen fondet e nevojshme

RAPORTI I AUDITIMIT 2012

Në të gjeturat e bëra nga Auditori për shpenzimet dhe blerjet në Departamentin e Prokurimit dhe të gjeturat për vitin 2012 vërehet mënyra se si auditori ka dhënë shumë rekomandime që nga viti 2010. Në të vërtetë shumë nga rekomandimet janë përsëritur edhe në vitin pasues

REKOMANDIMET E VITIT 2012 JANË ÇËSHTJE TË NGRITURA NGA AUDITORI SHI VIJON:

KONTRATA PA ZOTIM TË MJETEVE

Është viti i dytë që Auditori vëren shkelje si ajo që Komuna hyn në kontrata me operatorë ekonomik paraprakisht pa zotim të mjeteve. Këtë vit lidhjen midis kontratave pa zotim të mjeteve në vitin 2012 e ka hasur në tenderët si:

- “Mirëmbajtja e objekteve” - në shumë 304,774€; (Bazuar në data bazë, fituar nga Kompania CDC me datë tenderi 28 Shkurt 2012 me procedurë të hapur të tenderit dhe me lloj të kontratës Punë)
- “Rrethrotullimi në lagjen Iliria” në shumë 85,187€
- “Sinjalizimi horizontal dhe vertikal” në shumë prej 173,371€ (Bazuar në data baze, tenderë i fituar nga Kompania “Viva Print” me datë 20 Shkurt 2012 me procedurë të hapur të tenderit dhe me lloj kontratës Punë)

REKOMANDIMI I AUDITORIT PËR KRYETARIN E KOMUNËS

- Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që kontratat të mos nënshkruhen para zotimit të plotë të fondeve

VONESA NË PËRFUNDIMIN E PUNËVE

Komuna e Gjilanit kishte paguar faturën e datës 17 janar 2012 në vlerë 100,000€ ndaj OE ‘Bass-Com’ për situacionin e IV-të të punëve për projektin “Asfaltimi i rrugëve në fshatin Livoq i Ulët”. Kemi vërejtur një mungesë të konsistencës së dokumenteve për këtë pagesë. Situacioni i punëve ishte i datës

21 dhjetor 2010 ndërsa rikapitulimi për këtë situacion ishte i datës 12 dhjetor 2011. Kontrata për këtë projekt ishte lidhur më 23 nëntor 2009 në vlerë 314,219€. Sipas Planit Dinamik ky projekt ishte paraparë të përfundojë për 48 ditë pune. Përveç vonesave në planin dinamik, punët janë ndërprerë dhe projekti nuk ka përfunduar për shkak të mungesës së fondeve për përmbushjen e obligimeve ndaj OE. Për projektin “Asfaltimi i rrugëve në lagjen Dardania” në vlerë 525,675€ kemi vërejtur vonesa në kryerjen e punimeve. Kontrata ishte lidhur me 07 dhjetor 2009 dhe plani dinamik për përfundimin e punëve ishte 56 ditë pune. Komuna kishte paguar situacionin e shtatë të datës 19 janar 2012 në shumë 100,000 € dhe situacionin e tetë të datës 14 maj 2012 në shumë 72,544€. Ky projekt ende nuk është përfunduar për shkak të mungesës së fondeve.

Vonesa janë vërejtur edhe për projektin “Rregullimi i infrastrukturës publike në fshatin Shillovë” në vlerë 381,390€, sipas kontratës nga data 09 dhjetor 2010. Komuna kishte paguar faturën e datës 18 prill 2012 në shumë 70,170€. Punimet ende nuk janë përfunduar për shkak të mungesës së fondeve.

REKOMANDIMI I AUDITORIT PËR KRYETARIN E KOMUNËS:

- Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që punët kapitale të përfundojnë brenda afateve optimale dhe objektivisht të arritshme. Poashtu, menaxhmenti duhet të analizojë në hollësi afatet kontraktuese dhe arsyet e vonesave.

KONKLUZIONI HULUMTUES

- Ky sugjerim/rekomandim që i bëhet Komunës së Gjilanit është viti i 3-të rradhazi. Këto sugjerime janë si gjithmonë për vonesat si në ekzekutim të punëve në fillim të punimeve apo në përfundim të punimeve nga ana e kompanive të cilave u është dhënë tenderi. Komuna gjatë tri viteve nuk ka mundur të e ndalë këto vonesa që po ndodhin dhe s’ka mundur të adresoi këto rekomandime.

RAPORTI I AUDITIMIT 2013

Rekomandimet e vitit 2013 së bashku me shkeljet e Komunës në kategorinë e dhënies së kontratës dhe shkeljet që janë bërë me rastin e dhënies së këtyre kontratave.

KOMPENSIMI I ORGANEVE MBIKËQYRËSE

Komuna ka vazhduar të kompensojë punonjësit e saj të brendshëm në cilësinë e organeve mbikëqyrëse dhe komisionet për pranim teknik pavarësisht rekomandimeve tona të dhëna në vitin e kaluar për ta zgjidhur këtë çështje. Organet mbikëqyrëse janë kompensuar me 1% të shumës së përgjithshme të kontratës. Kontratat e identifikuar në vitin 2013 ishin: “Punë publike-projekte të vogla të infrastrukturës”; “Rregullimi dhe vendosja e semaforëve në qendër të qytetit” dhe “Hapja dhe rregullimi i rrugëve të rendit të tretë

REKOMANDIMI I AUDITORIT PËR KRYETARIN E KOMUNËS:

Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që sa më parë që kjo çështje të ngritët në Asamble Komunale për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme për të mbikëqyrur projektet duke siguruar pavarësinë dhe shmangur konfliktin e mundshëm të interesit.

Në kuadër të kërkesave teknike, ofertuesit “Bejta Commerce” dhe “Bass Com” (fituesi) kishin paraqitur një pjesë të pajisjeve (eskavator) me të njëjtat dokumente të pronësisë. Në dosje të tenderit nuk kishte ndonjë dëshmi (marrëveshje) për shfrytëzim të këtyre pajisjeve. Përveç kësaj, një sërë dokumentesh tjera të këtyre ofertuesve ishin krejtësisht të njëjta. Autoriteti kontraktues nuk kishte ndërmarrë asnjë masë për t’i sqaruar këto çështje ndonëse kishte indikacione për bashkëveprim nga këta dy ofertues.

REKOMANDIMI I AUDITORIT PËR KRYETARIN E KOMUNËS:

Kryetari i Komunës të sigurojë një monitorim të shtuar të komisioneve vlerësuese nga menaxheri i prokurimit gjatë vlerësimit të ofertave dhe aty ku vërehen indikacione të bashkëveprimit të ofertuesve, të raportohen tek menaxhmenti i lartë dhe të veprohet konform legjislacionit.

DHËNIA E KONTRATËS OPERATORIT EKONOMIK TË PA PËRGJEGJSHËM

Procesi i prokurimit për “Rregullimin dhe hapjen e rrugëve të rendit të tretë në Komunën e Gjilanit” ishte përcjellë me disa parregullsi:

Ofertuesi “Bejta Commerce” ishte shpallur si i pa përgjegjshëm nga autoriteti kontraktues për mosplotësim të kërkesave të stafit profesional. Ky arsyetim ishte i pa qëndrueshëm sepse ofertuesi kishte ofruar dokumentin e kërkuar.

RAPORTI I AUDITIMIT 2014 RAPORTI I AUDITIMIT 2015

Për vitin 2014 si pikë përmirësimi vlen të caktohet fakti që Zyra e Auditorit ka dhënë rekomandime Komunës së Gjilanit.

Në analizim e sipër kemi vërejtur se disa nga rekomandimet që Auditori i ka dhënë Komunës që nga viti 2010 janë duke u përsëritur.

Kjo do të thotë se Komuna nuk është munduar të marrë asnjë hap në adresimin e rekomandimeve.

Njëri ndër rekomandimet e përsëritur edhe këtë vit është dhënia e kontratës operatorit të përgjegjshëm sipas kërkesave të tenderëve.

DHËNIE E KONTRATËS OPERATORIT TË PA PËRGJEGJSHËM SIPAS KËRKESAVE TË TENDERËVE

Kontrata për "Furnizim me Teknologji Informative" për nevoja të Drejtorisë së Arsimit në shumë prej 9,900€ i ishte dhënë operatorit të pa-përgjegjshëm i cili nuk kishte plotësuar kërkesën e dosjes së tenderit për pagimin e tatimit ndaj Administratës Tatimore të Kosovës. Vërtetimi i ofruar i datës 04 nëntor 2014 tregonte se operatori ekonomik kishte obligime ndaj ATK-së.

REKOMANDIMI I AUDITORIT PËR KRYETARIN E KOMUNËS:

Kryetari duhet të shqyrtojë arsyet përse kontrata i është dhënë operatorit të pa përgjegjshëm. Një monitorim më i shtuar nevojitet ndaj komisioneve të vlerësimit për të siguruar një vlerësim të drejtë dhe sipas kërkesave ligjore.

Në vitin 2015 hapin mjaft çështje me rëndësi dhe mjaft dobësi që auditori është munduar që t'i jap rekomandime komunës së Gjilanit për përmirësime të mëtutjeshme, në veçanti në një departament siç është Prokurimi dhe shpenzimi i mjeteve të këtij departamenti.

Në vitin 2015 auditori ka bërë të gjetura mjaft me rëndësi të prioritetit të lartë. Nga shqyrtimi ai ka nxjerr edhe çështjen si:

DOBËSI SISTEMATIKE NË PROKURIM

Nga shqyrtimi i kontratave dhe pagesave auditori ka identifikuar një sërë dobësish të përbashkëta. Në veçanti, kontrollet menaxheriale nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive për të parandaluar çështjet që auditori ka vërejtur si:

Ka pasur një numër të konsiderueshëm të rasteve tek mallrat dhe shërbimet ku ishin aplikuar procedura për kuotimin e çmimeve, duke iu shmangur procedurave të hapura. Në testuam rastet si:

- 1 "Pastrimin e borës nga rrugët e qytetit dhe rrugët rurale" dhe përfitues ishte i njëjti OE. Vlerat e kontratave ishin 6,050€ respektivisht 6,500€ dhe
- 2 Unifikimi i mbishkrimeve në drejtoritë dhe zyrat komunale në vlerë 9,481€ dhe Unifikimi i mbishkrimeve në shkollat e Komunës së Gjilanit në vlerë 9,700€.

Tek kontrata "Rregullimi i kanalizimit atmosferik në lagjen Arbëria" në vlerë 201,489€, pas fillimit të punimeve, përmes aneks kontratës janë realizuar punë shtesë 20,020€. Këto dy kontrata nuk kanë mjaftuar për përfundimin e projektit, është dashur të nënshkruhet edhe një kontratë me kuotim çmimesh në vlerë 9,960€, për të përfunduar projekti. Kjo ka ndodhur si pasojë e planifikimit të dobët dhe shmangies së procedurave të hapura për pjesët e pa planifikuara.

Gjatë ekzaminimit fizik të mirëmbajtjes teknike renovimi i zyrës së vendit në fshatin Malishevë, organi mbikëqyrës ka pranuar disa pozicione të cilat nuk ishin përfunduar p.sh. si: Lyerja e jashtme e fasadës në sipërfaqe prej

78.55 m2 në vlerë prej 353€nuk ishte realizuar as 50% e sipërfaqes, ndërsa ishte paguar në tërësi. Furnizimi dhe vendosja e konstruksionit primar me lëndë 10x12 cm në sasi prej 3.65 m3 me vlerë 657€nuk ishte kryer.

REKOMANDIMI I AUDITORIT PËR KRYETARIN E KOMUNËS:

Kryetari duhet të siguroj një rishikim të rasteve të identifikuar për të gjetur shkaqet e ndodhjes dhe të marrë masat e duhura për evitimin e tyre në të ardhmen. Veçanërisht duhet të rris llogaridhënien e personave përgjegjës qoftë të njësisë kërkuese, zyrtarëve të prokurimit dhe menaxherëve të kontratave. Rrjedhimisht, duhet të vendosen kontrole të shtuara për të siguruar se dobësitë sistematike të identifikuar janë adresuar.

ÇËSHTJE TJETËR ËSHTË EDHE DOBËSI JO-SISTEMATIKE TË PROKURIMIT

Vlen të përmenden rastet si:

Kontrata për Asfaltimin e rrugës në Fsh. Zhegër, Sigurimi i ekzekutimit të kontratës kishte skaduar me datën 23 tetor 2015, edhe pse punimet sipas raportit përfundimtar të pranimit nga organi mbikëqyrës ishin kryer më 25 nëntor 2015. Sigurimi i ekzekutimit duhet të jetë valid për një periudhë 30 ditë pas përfundimit të kontratës. Në këtë rast për dy muaj nuk kishte siguri të ekzekutimit për të mbështetur kontratën;

•Në procedurën “Furnizimi me dru për ngrohje” në vlerë 259,540€ në dosjen e tenderit nuk ishin të specifikuar qartë karakteristikat e drurit, vetitë, kaloritë e drurit, i cili duhet të furnizohet por vetëm si dru për ngrohje. Çmimi i drurit në treg përcaktohet nga lloji i drurit, prandaj nuk dihet se si është vlerësuar pa e ditur llojin e ofruar

Koment:

Në të vërtetë edhe 5 vite pas po hasim pothuajse në rastin e njëjtë. Kujtojmë se në vitin 2010 në furnizim për ngrohje të Komunës së Gjilanit, firma që e ka ofruar qymyrin nuk e ka ofruar në përputhje të njëjtë me teknikun e kërkuar, e njëjta çështje po ndodh pothuajse përsëri me procedurën e furnizimit me dru për ngrohje ku nuk specifikohen qartë karakteristikat e drurit pasi që lloji i drurit ceket shume bukur që në treg varion më çmim të ndryshëm.

Prandaj po arrijmë përsëri në përfundim se Komuna e Gjilanit duhet ende të punojë në përmirësimin e disa çështjeve siç janë cekur edhe më lartë dhe në përmirësimin e tyre.

VENDIMET E ORGANIT SHQYRTUES TË PROKURIMIT, (OSHP)

Vendimet e Organit Shqyrtues të Prokurimit të gjitha janë të publikuara në web faqen kryesore të OSHP-së, të gjitha këto vendimet janë të ndara me vite dhe me tituj të kontratës të cilin autoriteti kontraktues ka marrë vendim për secilën prej tyre.

Që nga vitit 2010 deri tek viti 2015 janë të regjistruara gjithsej 49 vendime të publikuara për vite.

Në vitin 2010 anë të publikuara gjithsej 10 vendime, në vitin 2011 janë të publikuara 7 vendime, në vitin 2012 janë të publikuara gjithsej 7 vendime, në vitin 2013 të publikuara janë 7 vendime, poashtu në vitin 2014 janë të publikuara 8 vendime, ndërsa në vitin 2015 janë të publikuara 10 vendime.

VENDIMET E VITIT 2010:

Në vitin 2010 siç u shënuar më sipër, janë të publikuara gjithsej 10 vendime. Në analizimin e këtyre vendimeve kemi nxjerr që të gjitha vendimet të cilat ka marrë Organi Shqyrtues i Prokurimit për shpalljet dhe ankesat për Departamentin e Prokurimit afër KK Gjilan.

Vendimet e marra variojnë si në vazhdim, gjithsej të Pezulluara janë 4 vendime, të Aprovuara/Rivlerësim janë 6 vendime

Vendimet e pezulluara janë rikthyer nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për Operatorët ankues me arsyetimet se : Operoret Ankues nuk kanë arritur të depozitojnë sigurimin e ankesës, se ankesën që ka bërë operatori ankues kanë qenë të pabazuara dhe pa prova reale, se Operatori Ankues ka ofruar çmim më të lartë se firma fituese duke mos ju bazuar parimit për dhënie të kontratës, dhe se përsëri Operatori Ankues ka dështuar të depozitojë sigurimin e ankesës.

Vendimet e Aprovuara/të kthyer në rivlerësim janë kthyer nga Organi Shqyrtues i Prokurimit me arsyetimet si te baza nga operatorët ankues për AK GJILAN, të cilët konstatojnë se AK Gjilan ka bërë shkelje të disa normave ligjore të parapara sepse ka shkelur parime si : zgjedhjen e firmës fituese me çmimin më të ulët shkelje të këtij parimi ,metoda jo adekuate të vlerësimit të përzgjedhjes, shkelje në parimin e çmimit jo të favorshëm ekonomiksht dhe shkelje të parimit çmimi më i ulët ku fituese është firma me çmimin më të lartë se operatorët e tjerë . Gjithashtunjë rast kur KK Gjilan është dënuar me 5,000 euro gjobë dhe largim nga puna të një Zyrtari Ligjor dhe gjobë 1000 euro për këtë person.

VENDIMET E VITIT 2011:

Në vitin 2011 janë të regjistruara gjithsej 7 vendime, prej këtyre 7 vendimeve të pezulluara është vetëm 1 ndërsa të aprovuara janë 6 prej tyre.

Vendimi i pezulluar është rikthyer nga Organi Shqyrtues i Prokurimit për Operatorët ankues me arsyetimin se : pala ankuese në këtë rast operatori ankues nuk ka arritur ta bind komisionin vlerësues se autoriteti kontraktues KK Gjilan ka shkelur parimin dhënie e tenderit për firmën më çmimin më të ulët.

Vendimet e Aprovuara/të kthyer në rivlerësim, janë kthyer nga Organi Shqyrtues i Prokurimit me arsyetimet si te baza nga operatorët ankues për AK GJILAN, ata konstatojnë se AK Gjilan ka bërë shkelje të disa normave ligjore të parapara sepse ka shkelur parime si: shkelje e parimit për dhënie të kontratës për çmimin më të ulët duke dhënë firmës fituese për çmimin më të lartë që ka dhënë ajo, shkelje se Komuna ka eliminuar operatorin e përgjegjshëm dhe se ky operator ka ofruar dokumentacione të nevojshme sidhe mos respektim të dispozitave ligjore për dhënie të kontratës.

VENDIMET E VITIT 2012:

Në vitin 2012 janë të regjistruara gjithsej 7 vendime, prej këtyre 7 vendimeve të pezulluara ndaj operatorëve ekonomik janë 2 vendime, të aprovuara ndaj operatorëve

ekonomik dhe Autoriteti Kontraktues janë 3 të aprovuara dhe 2 të tjerë janë si urdhër zbatim për autoritetin kontraktues si njoftim nga OSHP për zbatim të marrëveshjeve qysh nga data e publikimit.

Deri në vitin 2012 shihet që në shumicën e rasteve OSHP ka aprovuar kërkesat e operatorëve ekonomik sepse Autoriteti Kontraktues në të shumtën e rasteve ka bërë shkelje të normave ligjore duke ua dhënë mundësinë disa firmave të fitojnë tenderë edhe pse oferta e tyre kalon parimin e parësor çmimi më i ulët

VENDIMET E VITIT 2013:

Në vitin 2013 gjithsej janë të publikuara 7 vendime, prej këtyre 7 vendimeve janë 3 refuzime ndaj operatorëve ankues, 3 aprovime ndaj të njëjtëve operatorë ku njëri ndër aprovimet është edhe tërheqje nga tenderimi i një kompanie vendore me arsyetimin se kanë projekte të tjera dhe se nuk kanë kohë për tenderime të ngjashme, gjithashtu është një Anulim për një kërkesë nga një palë e pakënaqur ku Organi Shqyrtues i Prokurimit ka anuluar kërkesën e tij si të pabazë pasi që raporti i ekspertizës tregon se nuk ka ndonjë shkelje nga ana e Autoritetit Kontraktues për Operatorin Ankues.

Arsyetimet e Aprovimit nga ana e Organit Shqyrtues për Operatorët Ankues: shkelje e dispozitave ligjore nga ana e Autoritetit Ankues dhe largim i pabazë nga tenderimi i një firme me pretekstin se nuk është e favorshme për tenderim, mirëpo është e vërtetuar nga Gjykata Ekonomike se ka të bëjë me një operator të favorshëm dhe se mund të marrë pjesë në tenderim.

VENDIMET E VITIT 2014:

Në vitin 2014 ekzistojnë gjithsej të publikuara 8 vendime, prej të cilave janë 2 pezullime, 3 aprovime, 1 urdhër për ekzekutim të vendimit dhe 1 tërheqje të ankesës si palë e pakënaqur.

Përsëri ekziston e njëjta çështje që Organi Shqyrtues bën aprovimin e kërkesës nga Operatori Ankues sepse sipas të njëjtëve AK Gjilan po bën shkelje në dhënien e kontratave duke shkelur dispozitat ligjore dhe parimet e përzg-

jedhjes si çmimet më të ulëta dhe çmimet ekonomikisht të favorshme.

Pezullimet ndaj operatorëve ankues janë bërë me qëllimin se këta të fundit nuk kanë paraqitur prova dhe se ankesat janë të pabazuara.

VENDIMET E VITIT 2015:

Në vitin 2015 gjithsej janë të publikuara 10 vendime, prej tyre të pezulluara/refuzuara nga Organi Shqyrtues i Prokurimit janë të pezulluara/refuzuara për Operatorët ankues nuk kanë refuzuar asnjë, të gjitha janë të aprovuara për rishikim të mëtejme, 3 prej tyre janë të aprovuara si tërheqje ankese nga operatorët ankues pas shpalljes së datës së ankimit dhe pas dërgesës së ankimit, ndërsa 7 të tjera janë të aprovuara për rishikim.

Vlen të potencohet që përsëri dhe vite e vite normat dhe shkeljet e dispozitave ligjore po rriten, pasi që aprovimet e shumta dhe vërejtjet kryesore që OSHP ka dhënë për AK KK Gjilan janë se është duke shkelur dispozitat ligjore duke mos ju përmbajtur aspak parimeve që në fillim i parasheh si: mos respektim i parimit çmimi ekonomikisht më i favorshëm apo çmimi më i ulët dhe shkelje të neneve përkatëse.

Mund të ceket një ndër rastet kur një operatorë ankues para panelit shqyrtues ka parashtruar ankesë për tenderin e dhënë nga AK Gjilan, edhe pse i njëjti nuk kishte baza të akuzimit mirëpo pretendonte se Operatori tjetër ka borxhe në ATK, ndër tjera. Pas analizimit është vërtetuar se firma që pretendohet që nuk ka vulën dhe certifikatën e vulosur në ATK edhe pse OSHP ka dhënë urdhrin për anulim të dhënies së kontratës, i njëjti edhe figuron si fitues i tenderit në fjalë.

FINANCIMI I SUBJEKTEVE POLITIKE

Raportet e auditura të pasqyrave financiare janë të publikuara vetëm për vitet 2009-2012. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve nuk i ka publikuar asnjëhere pasqyrat financiare të SP për vitet para vitit 2009, pasi ato janë audituar nga OSBE.

Ndërsa pasqyrat financiar të SP politike pas vitit 2013 nuk janë të audituara sepse Kuvendi i Kosovës ka dështuar të përzgjedhë kompanië për auditim.

KK Gjilan gjatë viteve 2007-2015 është qeverisur nga dy subjektet më të mëdha në vend, nga PDK dhe LDK.

LDK gjatë viteve 2009-2012 ka raportuar 99,685 euro të hyra nga donacione, prej tyre 76,811 euro nga persona fizikë dhe 22,874 euro nga persona juridikë.

Në vitin 2009 auditori ka gjetur që LDK ka shitur patundshmëri në vlerë 380,000.00 euro duke shkelur rregulloren 01/2008 Neni 17 Financimi i partive politike, paragrafi 17.4 sipas te cilit "Partia e regjistruar politike nuk mund të hyjë në asnjë lloj veprimtarie financiare apo fitimprurëse, përpos shitjes së të mirave siç janë publikimet ose posterët me emblemën apo akronimin e partisë në shumë të përgjithshme jo më të madhe se dy mijë (2,000.00) euro në vit.

LDK në vitin 2010 për shkak të tejkalimit të limit ditor për pranim të donacioneve është obliguar që të kthejë tek donatorët 2,856.95 euro

PDK gjatë viteve 2009-2012, ka pranuar në formë donacioni 502,084 euro nga persona fizikë dhe juridikë.

Në shumë raste auditori ka gjetur tejkalim të shpenzimeve gjatë fushatave zgjedhore, dhe tejkalim të limit për pranimin e donacioneve brenda ditës.

LIDHJA E BIZNESEVE ME SUBJEKTET POLITIKE

Nga të dhënat e që janë marrë nga KRPP dhe të cilat janë krahasuar me të dhënat e ARBK-së dhe Raportet e pasqyrave financiare të SP politike, janë gjetur 18 kompani të cilat kanë financuar SP dhe kanë fituar tenderë në KK Gjilan.

Këto kompani kanë fituar rreth 19.5 milionë euro nga KK Gjilan.

Kompanitë që kanë financuar PDK-në gjatë viteve 2009-2012 kanë fituar më së shumti tenderë.

PDK ka pranuar donacion rreth 60,000 euro nga 15 kompani të cilat kanë fituar tenderë publik nga KK Gjilan.

VLERA E DONACIONEVE TË PRANUARA NGA PDK, NGA KOMPANITË QË KANË MARRË TENDERË

Arianiti-a	€ 500.00
Bejta Commerce	€ 10,000.00
Elmak	€ 1,000.00
C D C	€ 2,000.00
Engineering	€ 2,000.00
Euro trans	€ 11,000.00
Magjistranja	€ 5,000.00
Mega	€ 10.00
Merkatori	€ 500.00
Metali	€ 1,000.00
Riza trans	€ 8,500.00
Viva Print	€ 1,000.00
Vizion Project	€ 1,000.00
Compact Group	€ 2,577.00
Tali	€ 20,000.00

VLERA E TENDERËVE TË FITUAR NGA KOMPANITË QË FINANCUAN PDK-NË

Arianiti-a	€ 1,211,123.11
Bejta Commerce	€ 5,707,631.11
Elmak	€ 94,765.45
C D C	€ 1,331,506.00
Engineering	€ 171,747.00
Euro trans	€ 1,062,239.15
Magjistranja	€ 3,271,045.23
Mega	€ 522,781.23
Merkatori	€ 145,685.05
Metali	€ 62,750.00
Riza trans	€ 352,519.00
Viva Print	€ 647,955.55
Vizion Project	€ 222,217.00
Compact Group	€ 151,236.00
Tali	€ 4,572,997.90

Këto kompani kanë fituar rreth **120 tenderë** në vlerë **19,150,000.00 euro**.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka pranur donacion nga një kompani 20,000 euro. Kjo kompani ka fituar tre

tenderë në KK Gjilan në vlerë 200,000.00 euro

	Tenderë	Shuma
PETROL COMPANY 	3	€ 200,000.00

Lëvizja Vetëvendosje ka pranuar donacion nga tri kompani, në vlerë 950 euro, dy nga këto kompani kanë qenë edhe financuese të PDK-së.

Këto tri kompani kanë fituar në KK Gjilan rreth 30 tenderë në vlerë afro 5 milionë euro

HAXHI JAHA LVV		3	€ 67,635.00
TALI PDK-LVV		26	€ 4,572,997.90
COMPACT GROUP PDK-LVV		3	€ 151,236.00

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Gjithashtu hulumtimi tregon se rekomandimet e Zyrës së Auditorit Gjeneral, nuk janë zbatuar ndër vite, edhe pse të rekomanduara.

Bazuar në hulumtimin tonë, Komuna e Gjilanit del të ketë probleme të shumta sa i përket buxhetit, në veçanti në fushën e prokurimit publik.

Hulumtimi ynë dhe Raporti i Auditorit kanë identifikuar probleme të shumta të cilat ndikojnë në operimin funksional buxhetor. Në periudhën 2010 – 2015, janë identifikuar probleme duke filluar me shkeljen e dispozitave ligjore të Prokurimit Publik, procedurat jo-efikase të Komunës në prokurimin publik në përputhje me rregullat ekzistuese të prokurimit, lidhjet dhe favoret politike për ndërmarrjet në rastet e ndarjes së tenderëve, kontratat në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik.

Adresimi i rekomandimeve ishte rekomanduar nga Zyra e Auditorit Gjeneral, mirëpo po në raportin e Auditorit, përsëri vihet në pah mos-adresimi i rekomandimeve nga autoritetet përgjegjëse komunale.

Problemet tjera të cilat kanë vazhduar ta përcjellin Komunën Gjilanit përgjatë viteve ishin gjithashtu problemet me njoftimin për dhënie të kontratës si dhe dhënia e kontratës për OE (Operatori Ekonomik) të cilët nuk kishin plotësuar kriterin për veprimtari përkatëse sipas kërkesës së specifikuar, anashkalimi i procedurave të

prokurimit publik me rastin e shpalljeve të hapura publike.

Vështirësi ishin identifikuar edhe me rastin e ekzekutimit të kontratave me ç'rast është vonuar në përmbushjen e obligimeve që rrjedhin nga kontrata, dhënie e kontratave operatorëve ekonomik të papërgjegjshëm dhe probleme tjera të identikuara në periudhën 2010 – 2015.

E gjithë kjo kishte shkaktuar probleme të vazhdueshme në funksionimin normal të Komunës sa i përket shpenzimit të parasë publike dhe respektimit të dispozitave ligjore, në veçanti atyre për prokurimin publik.

Ndër rekomandimet e shumta që dalin nga Hulumtimi dhe Raporti i Auditorit janë rekomandimet si:

- Respektimin e kontratave dhe përmbushjen e kriterëve të kërkuara sipas dosjes së tenderit;
- Analizimin dhe marrjen e masave të duhura administrative për rastet e keq menaxhimit;
- Kompensimet e organit mbikëqyrës dhe komisionit për pranim teknik të punëve të bëhen jashtë kontratave për punë dhe të mos futen në koston e ndërtimit;

- Realizimi i projekteve me kohë dhe në rastet e vonesave të aplikohen ndëshkimet për kontraktoret që nuk i përmbushin kushtet dhe obligimet e përcaktuara me kontratë;
- OE të ofrojnë garancion bankar për sigurinë e ekzekutimit të punëve;
- Të mos iniciohen procedurat e prokurimit para se të sigurohen mjetet e nevojshme;
- Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që kontratat të mos nënshkruhen para zotimit të plotë të fondeve;
- Kryetari i Komunës duhet të sigurojë që punët kapitale të përfundojnë brenda afateve optimale dhe objektive të arritshme;
- Menaxhmenti duhet të analizojë në hollësi afatet kontraktuese dhe arsyet e vonesave;
- Kryetari i Komunës të sigurojë një monitorim të shtuar të komisioneve vlerësuese nga menaxheri i prokurimit gjatë vlerësimit të ofertave dhe aty ku vërehen indikacione të bashkëveprimit të ofertuesve, të raportohen tek menaxhmenti i lartë dhe të veprohet konform legjislacionit;
- Kryetari duhet të shqyrtojë arsyet përse kontrata i është dhënë operatorit të pa përgjegjshëm;
- Monitorim më i shtuar nevojitet ndaj komisioneve të vlerësimit për të siguruar një vlerësim të drejtë dhe sipas kërkesave ligjore;
- Kryetari duhet të sigurojë një rishikim të rasteve të identifikuar për të gjetur shkaqet e ndodhjes dhe të marrë masat e duhura për evitimin e tyre në të ardhmen. Veçanërisht duhet të rris llogaridhënien e personave përgjegjës qoftë të njësisë kërkuese, zyrtarëve të prokurimit dhe menaxherëve të kontratave. Rrjedhimisht, duhet të vendosen kontrole të shtuara për të siguruar se dobësitë sistematike të identifikuar janë adresuar

Zbatimi dhe adresimi i rekomandimeve edhe për Komunën e Gjilanit do të duhej të konsiderohej çështje me prioritet nga organet relevante komunale. Adresimi i problemeve të tilla nga ana e Komunës, do ndihmonte në adresimin e problemeve të shumta ndër vite e dhe gjithashtu do të ndikonte në evitimin dhe mos-përsëritjen e problemeve të tilla në vitet pasuese.

